



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

## PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2017/2018

# TESTI GJUHË SHQIPE

### UDHËZIM PËR PUNË

- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **120** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).
- Plotësoje testin me **stilolaps** (gjatë zgjidhjes së detyrës duhet të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën).
- Përgjigjeve të shkruara me stilolaps nuk mund t'u biesh vizë ose t'i korrigjosh.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shkruaj asgjë. Kjo është hapësirë në të cilën kontrolluesi do t'i shënojë pikat. Në këtë dhe në faqen e fundit gjithashtu nuk mund të shkruash asgjë.
- Nëse e mbaron më herët, dorëzoje testin dhe ngadalë dil jashtë që të mos e pengosh punën e të tjerëve.

**Të dëshirojmë sukses në punë!**

## 1. Gomari në festë

- Gomari ishte i mërziur sepse kafshët e shanin, duke thënë, se je shumë i shëmtuar.

Një ditë ai përgatiti një maskë të bukur, e veshi dhe u nis në festën e kafshëve.

Kur mbërriti, të tëra kafshët e përshëndetën dhe askush nuk e njohu. Gomari u ndie i lumtur dhe nga gëzimi e lëshoi një pëllitje të fortë.

Kafshët u shtangën e mbetën gojëhapur. Ato e kuptuan se pas maskës fshihej gomari. Filluan të qeshin e të tallen me të. Gomari sa nuk plasi nga inati. U ngrit nga vendi dhe iku në shtëpi i vetmuar.

Lexo tekstin e lartshënuar dhe trego:

Gomari është:

a) I bindur;

b) I shëmtuar;

c) I dobishëm.

## 2. Në këmbët e një gështenje jetonte një kërpudhë e madhe, me kësule të kuqe me pika të bardha. Nën kërpudhë jetonin të lumtura tri shoqe: nuse pushka, milingona dhe larva.

Erdhi dimri dhe kërpudha nuk kishte mundësi t'i mbronte nga të ftohtët. Shoqet vendosën të shkonin te trungu i gështenjës, mirëpo nuk i treguan kërpudhës, sepse ajo do të mërziqej.

Bënë si bëjnë dhe një ditë morën rrobat dhe u larguan.

Por shoqet nuk e harruan kërpudhën. Ato shkonin çdo ditë dhe e përshëndetnin. Kështu, kërpudha nuk u ndie e vetmuar.

Lexo tekstin e lartshënuar me kujdes dhe jep përgjigjen e saktë para pyetjes.

a) Kush janë shoqet e kërpudhës?

\_\_\_\_\_

b) A e ndienin të ngrohtë nën kërpudhë?

\_\_\_\_\_

c) A e harruan shoqet kërpudhën?

\_\_\_\_\_

3.

Nina - nana djalin

Flej, o djalë, t'i flejsh i bardhë  
 E gjithkund tu dhashtë mbarë!  
 Ma gzofsh emnin të ta kam ngjitë.  
 Mori mollë, ma gzofsh të ritë!  
 Lumja nana, bir, që të ka,  
 Bir që t'ka edhe të pastë,  
 Me të mirë mbrapa të lantë  
 Të mira, bir, sa zemra të dashtë.

Teksti i lartshënuar është:

- a) Poezi;
- b) Këngë djepi –Ninullë;
- c) Poemë.

4. Në vizat e dhëna shkruaj klasat e fjalëve që janë pjesë të pandryshueshme.

- 1. \_\_\_\_\_;
- 2. \_\_\_\_\_;
- 3. \_\_\_\_\_;
- 4. \_\_\_\_\_;
- 5. \_\_\_\_\_;

Trego përse janë të pandryshueshme:

---



---



5. Gjej dhe shkruaj sipas rregullave drejtshkrimore fjalët e shkruara gabimisht në fjalinë e dhënë.

Hana kishte depërtuar në çdo skutë dhe drita kishte bo, që ne ta shofin njani tjetrin.

---

6. Shkruaj drejt fjalët e poshtëshënuara.

shkamb \_\_\_\_\_; dam \_\_\_\_\_; dhanë \_\_\_\_\_;

kangë \_\_\_\_\_; syni \_\_\_\_\_; zoqtë \_\_\_\_\_.

7. Emrat e dhënë ndaji në dy shtylla sipas gjinisë:

Dardha, ujku, speci, molla, limoni, shtëpia, trëndafili, domatja, bregu, rrushi, vajza, çerdhja.

Emra të gjinisë mashkullore	Emra të gjinisë femërore

8. Lidh emrat sipas kuptimit. Shkruaj sipas modelit, për shembull **Syze – Sy**, dhe lidh me shigjetë shembujt në vazhdim. Ndiq shembullin e dhënë.

syze — trëndafil

kartolina — shkollë

parfumeri — ski

e trëndafilte — sy

**9.** Fjalët:Furrtar, kulturor, muzikor, sahatçi, janë:

a) Fjalë të parme.

b) Fjalë të përbëra;

c) Fjalë të prejardhura.

Rretho përgjigjen e saktë.

**10.** Klasifiko emrat e dhënë në kllapa:

(gjel, Moxarti, hidhërimi, ekran, ide, arinj, lumë,gëzim, shok, Migjeni)

1. Frymorë: \_\_\_\_\_

2. Abstrakt: \_\_\_\_\_

3. Të përveçëm: \_\_\_\_\_

4. Frymorë të përgjithshëm: \_\_\_\_\_

Vërejtje: në klasifikim mund të përsëriten emrat.

**11.** Bashkëtingëlloret e poshtëshënuara *r*, *rr* janë:

a) *Hundore*;

b) *Grykore*;

c) *Dridhëse*.

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë.

**12.** Në fjalitë e dhëna, fjalët e nënvizuara janë rrethanorë.

Shkruaj më poshtë llojin e tyre.

1. Ai shtrëngoi më mirë trupin.
2. U kthyem djathtas.
3. Ndërtuan murin pesë metra të lartë.
4. Trimat ranë për liri.
5. Qyteti u dëmtua nga uji.

1. Rrethanor \_\_\_\_\_

2. Rrethanor \_\_\_\_\_

3. Rrethanor \_\_\_\_\_

4. Rrethanor \_\_\_\_\_

5. Rrethanor \_\_\_\_\_

**13.** Nyja të te mbiemrat e nyjshëm, a vlen për të dy gjinitë dhe cilin numër tregon?

\_\_\_\_\_

Shkruaj përgjigjen në vizën e dhënë.

**14.** Klasifiko pjesët e secilit grup të fjalisë.

Pjesët e dhëna në kllapa shkruaj në shtyllat e dhëna  
(rrethanori, përcaktori, kundrinori i drejtë, kryefjala, kundrinori i zhdrejtë, kallëzuesi)

a) Grupi emëror	b) Grupi foljor

## 15.

Shiko, më shiko, mo e dashur,  
 nesër do të nisem.  
 Nesër do të nisem moj e dashur,  
 n'Gjermani do t'shkoj.  
 N'Gjermani do t'shkoj, moj e dashur  
 tye s'të harroj.  
 Tye s'të harroj, moj e dashur,  
 me letra do t'kujtoj.  
 Me letra do t'kujtoj, moj e dashur,  
 selam do të bëj.

Lexo Vargjet e dhëna dhe nga kuptimi i këtyre vargjeve këto këngë quhen:

a) Këngë të \_\_\_\_\_

b) I përkasin letërsisë \_\_\_\_\_

## 16. Lexo me vëmendje vargjet e shënuara dhe trego se ç'janë.

Rretho shkronjën përpara përgjigjes së saktë:

*Vrap e vrap e të Dhoqina.  
 -Mirë se erdhe, im vëlla!  
 Në ke ardhë për të mirë,  
 të vishem si gjeraqinë;  
 në ke ardhë për të keq,  
 të vishem si kallogjer.  
 - Jo, motër, sikundërje!  
 E hipi në vithe të kalit.  
 Zogjtë udhës thoshin:  
 „Cili-viu, ciu-viu,  
 kush ia bën, ai bën vetiu!  
 Kini parë e s'kini parë?  
 Shkon një bishtbardhë,  
 I vdekuri me të gjallë!”*

a) letërsi e shkruar

b) letërsi gojore

c) letërsi artistike

**17.**

## Gjergj Elez Alia

Trim mbi trima kish qenë gjithmonë Gjergj Elez Alia. Vjete e vjete ai i kish dalë zot truallit të të parëve ia kish mbrojtur nderin. Kish luftuar me topuz e shpatë kundër armiqve të dredhur këtej nga deti e nga toka për të shkelur vendin, për ta dhunuar e zhveshur. Dhe gjithë këta armiq Gjergj Elez Alia i kish shtrirë përtokë pa frymë

Lexo tekstin e dhënë dhe duke rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë trego se cilit lloj të gjinisë letrare i takon:

- a) Lirikës;
- b) Epikës;
- c) Dramatikës.

**18.** Lexo vargjet e mëposhtme.

*Flej , o djalë , ti fletsh i bardhë  
E gjithkund t'u dhashtë mbarë!  
Ma gëzofsh emrin që ta kam ngjitë.  
Mori mollë, ma gëzofsh të ritë!  
Lumja nana , bir që të ka.*

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë:

- a) *Këngë kreshnike;*
- b) *Këngë legjendare;*
- c) *Këngë djepi.*



**19.** Lexo poezinë dhe trego figurën letrare të cilën e hasim në këto vargje:

Tanusha

E une Tanushën vetë e kam pa  
 Gja ma t` mirë s sheh njeri nën këtë diell  
 Vetulla e saj si fiskaja,  
 Shtegu i ballit, si shtegu i malit,  
 Kur merr hana me me prendue,  
 Syri i saj, si kokkra e qershis,  
 E ka qerpikun, si krahu i dallëndyshes  
 Fytyra e saj, si kuqet molla n degë,  
 Hunda e drejtë-o, si kalemi i Tushës  
 Goja e vogël si lulja që shpërthen,  
 Dhëmbët e bardhë, si gurrzit e lumit.

Rreto shkronjën para përgjigjes së saktë:

- a) Personifikimin;
- b) Hiperbolës;
- c) Krahasimimit.

**20.** Rima grupohet në tri lloje:

AABB (vargu i parë rimon me të dytin)  
 ABAB (vargu i parë rimon me të tretin)  
 ABBA (vargu i parë rimon me të katërtin)

Rendit secilin grup ne vendin e duhur, pra cila është?

- a) Rimë e mbyllur \_\_\_\_\_
- b) Rimë e kryqëzuar \_\_\_\_\_
- c) Rimë e puthitur \_\_\_\_\_